



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA KORÇË
KËSHILLI BASHKIAK

Njoftim per konsultim publik

Këshilli i Bashkisë Korçë

Titulli: Mbledhja e rekomandimeve për PBA 2026-2028, Paketën Fiskale 2026 dhe Buxhetin 2026.

Propozuesi: Projekt aktet janë propozuar nga Ekzekutivi/Kryetari i Bashkisë, Z. Sotirajq Filo

Sqarime për projekt aktin: *Nevojat e komunitetit për përmirësimin e shërbimeve publike dhe investimeve bazuar në buxhetin 2026-2028*

Kalendari i konsultimit: Konsultimi publik do të realizohet në datat si më poshtë:

Nr.	Njësia Administrative	Data	Ora	Vendi
1	Nj.A. Vithkuq	28.10.2025	15:00	Vithkuq
2	Nj.A. Mollaj	28.10.2025	17:00	Mollaj
3	Nj.A. Voskopojë-Lekas	29.10.2025	16:00	Voskopojë
4	Nj.A. Voskop	29.10.2025	17:00	Voskop
5	Nj.A. Drenovë	31.10.2025	16:00	Drenovë
6	N. A. Bulgarec	03.11.2025	16:00	Bulgarec
7	Rajonet 1, 2, 3 Korçë	04.11.2025	18:00	Biblioteka

Banorët do të kenë mundësi të konsultojnë dokumentat në lidhje me çështjet për diskutim në linkun e mëposhtëm për PBA 2026-2028:

chrome-extension://efaidnbnmnnibpcajpcgiclfndmkaj/https://bashkiakorçe.gov.al/wp-content/uploads/2025/09/5.-PBA-2026-2028_compressed.pdf

dhe për Paketën fiskale e cila është e pandryshuar nga viti 2025 te dhenat i gjeni në linkun me poshtë:

<https://bashkiakorçe.gov.al/2025/03/20/taksa-dhe-tarifa-2025/>

Pjesëmarrës:

- **Nga ana e Bashkisë dhe e këshillit bashkiak:** Anëtarët e Këshillit Bashkiak, Përfaqësues nga ekzekutivi, Anëtarët e Komisionit të Ekonomisë dhe Financës të Këshillit të Bashkisë, Kryetarja e Aleancës së Grave Këshilltare, Koordinatori për Njoftimin dhe Konsultimin Publik, Zyra e Financës së bashkisë,

-



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA KORÇË
KËSHILLI BASHKIAK

- **Nga komuniteti:** Banorët e qytetit të Korçës, banorë dhe përfaqësues nga NJA, kryetarët e fshatrave, përfaqësues nga institucionet, përfaqësues nga biznesi, përfaqësues nga grupe të marginalizuara, OJF, etj

-Forma e konsultimit: Takim publik

Qëllimi i këshillimit publik	1. Evidentimi i nevojave të komunitetit për përmirësimin e shërbimeve dhe investimeve publike bazuar në buxhetin e 26-28
Përshkrimi i çështjeve që trajton projekt buxheti afatmesëm	Miratimi i projekt buxhetit afatmesëm është një vendim i rëndësishëm që merret nga Këshilli i Bashkisë, pasi përcakton fondet që do të përdoren për të gjitha shërbimet / funksionet e ushtruara nga Bashkia dhe performancën e tyre. Këshilli i Bashkisë duhet të sigurohet që fondet publike shkojnë për përmirësimin e shërbimeve që ofrohen nga Bashkia për komunitetin dhe adresojnë nevojat e tyre, brenda kapaciteteve financuese të Bashkisë. Për këtë, Këshilli i Bashkisë do të organizojë këtë konsultim publik për të marrë mendimin dhe sugjerimet e qytetarëve për mënyrën se si janë përdorur fondet gjatë vitit 2025, nivelin e arritjes së objektivave të shërbimeve, si dhe listën me shërbime / funksioneve nga e cila komuniteti për zgjedh ato shërbime për të cilat mendon se bashkia duhet të shpenzojë më shumë gjatë tre viteve të ardhshme.
	Këshilli i Bashkisë është i interesuar të marrë opinionin e komunitetit në lidhje me çështjet si vijon : 1. A jeni dakort me mënyrën si janë shpenzuar paratë?



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA KORÇË
KËSHILLI BASHKIAK

<p>Pyetjet që ngre Këshilli ndaj publikut</p>	<ol style="list-style-type: none">2. Cilat jane nevojat tuaja per te cilat duhen permiresuar sherbimet nga ana e Bashkise?3. Cilat janë shërbimet prioritare për të cilat bashkia duhet të shpenzojë më shumë fonde publike gjatë periudhës 2026 – 2028?4. Për cilin shërbim publik jeni më të kënaqur?5. Tjetër
<p>Shpjegim të procesit që do ndjekë dhe veprimet që do të ndërmarrë Këshilli për të shqyrtuar rekomandimet nga publiku deri në marrjen e vendimit</p>	<p>Pas mbledhjes së rekomandimeve, Këshilli i Bashkisë do të ndjekë hapat si vijon:</p> <ol style="list-style-type: none">1. Realizimin nga ana e Sekretariatit të Këshillit i një Përmbledhje të Rekomandimeve dhe rezultateve të plota të takimit që përfshin të gjitha mendimet dhe propozimet që do të vijnë nga komuniteti dhe bërja publike e kësaj Përmbledhje;2. Dërgimi i kësaj Përmbledhje Rekomandimesh Kryetarit të Bashkisë, Komisionit të Ekonomisë dhe Financës, taksave dhe tarifave dhe çdo këshilltari të bashkisë;3. Shqyrtimi nga ana e komisionit të ekonomisë dhe financës, taksave dhe tarifave (mbledhja e komisionit është e hapur për publikun sipas datave të parashikuara në kalendar) të cdo rekomandimi dhe të opinionit të Kryetarit të Bashkisë;4. Marrja e vendimit për rekomandimet që do të përfshihen në projekt buxhetin afatmesëm dhe projekt buxhetin vjetor. Vendimi i bashkëngjitet dokumentit të projekt buxhetit afatmesëm dhe projekt buxhetit vjetor;5. Diskutimi dhe miratimi i aktit në seancën e hapur të Mbledhjes së Këshillit;6. Informimi i komunitetit, për marrjen në konsideratë të rekomandimeve ose për mosmarrjen në konsideratë dhe arsyet e mosmarrjes në konsideratë të tyre;7. Publikimi i aktit në faqen e Këshillit të Bashkisë dhe në tabelat e informimit;8. Njoftimi i administratës për aktin e miratuar;9. Monitorimi i zbatimit të tij.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA KORÇË
KËSHILLI BASHKIAK

Ndryshimet kryesore dhe/ose alternativat e mundshme	Opsionet e mundshme janë për t'u shqyrtuar nga ana e Këshillit tone : Ndryshime në alokimin e fondeve për programe të caktuara me qëllim përmirësimin e shërbimeve të ofruara nga Bashkia.
Kontaktet dhe afatet e degimit te komenteve, rekomandimeve, verejtjeve	Sugjerimet janë të mirëpritura deri më datë 15 Nëntor 2025, në adresen e email: eva.naci@bashkiakorçe.gov.al
Data e publikimit	06.10.2025